



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT

Drejtoria	<b>Drejtoria e Shëndetësisë</b>
Periudha Raportuese	<b>Dhjetor, 2020</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	<b>Dr. Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë</b>
Përgatitur	<b>Dr. Fatlinda Hoxha - Zyrtare për shëndetësi në Drejtorinë e Shëndetësisë</b>

#### 1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes - ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit dhjetor 2020 Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 30 lëndë të ndryshme për tu shqyrtuar nga stafi i saj si dhe nga komisioni profesional.

Stafi në këtë drejtori, kishte takime të përditshme me qytetarë për tu njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

#### 2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Monitorim dhe mbështetje të aktiviteteve bazuar në kontratat aktive;

- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja, si dhe në QMU;
- Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i Plan prokurimi 2020;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të drejtorisë.

### 3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

- Përmes identifikimit të nevojave për shërbime shëndetësore cilësore, përpilohet buxheti 2021, si dhe plan prokurimi 2021;
- Identifikimi i nevojave rreth përpilimit të specifikave:
  - Furnizim emergjent me reagensin "D" Dimer;
  - Furnizim emergjent me reagens serologjik COVID 19;
  - Furnizim me material mjekësor kundër COVID-19;
- Përcaktohet ekipi vlerësues:
  - Furnizim me barna dhe material shpenzues për QKMF dhe QMU për personat me COVID-19;
  - Furnizim me teste antigjen COVID-19;
  - Furnizim me strisho rapide për antigjen;
  - Furnizim emergjent me reagens "D" Dimer;
  - Furnizim emergjent me reagens serologjik COVID 19;
  - Furnizim me material mjekësor kundër COVID-19;
- Përcaktohet ekipi menaxhues dhe monitorimi i aktiviteteve;
  - Furnizim me barna dhe material shpenzues për QKMF dhe QMU për personat me COVID-19;
  - Furnizim me teste antigjen COVID-19;
  - Furnizim me strisho rapide për antigjen;
  - Furnizim emergjent me reagens "D" Dimer;
  - Furnizim emergjent me reagens serologjik COVID-19;
  - Furnizim me material mjekësor kundër COVID -19;
- Monitorim i aktiviteteve;
  - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objekteve KPSH-së;
    - Hapësira QMF 5; suterren; adaptim i hapësirës për arkiv dhe zhveshtores të personelit stomatologjik;
    - Përmirësimi i hapësirës për ofrimin e shërbimeve radiologjike në QMF 5;
- Publikohet për ofertim;
  - Ndërtimi i QMF në Lagjen "Veternik";
  - Furnizim me inventar për nevojat e objekteve të KPSH-së;
- Vaksinim i qytetarëve nga gripi sezonal;

- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja si dhe në QMU.



- Fillon testimi me teste rapide (të shpejta) antigjenike në Qendrën e Mjekësisë Familjare 7, në lagjen “Emshir”, i cili ka një besueshmëri prej 99.7% të rastet pozitive.

- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
- Në prioritet ndërmarrjen e masave preventivë rreth parandalimit të koronavirusit;
- Njoftim i vazhdueshëm rreth riorganizimit të personelit shëndetësor mbi gatishmërinë e përhapjes së koronavirusit;
- Gjatë muajit dhjetor, 4870 qytetarë ishin pozitiv me COVID-19;
- Drejtoria e shëndetësisë gjatë vitit 2020, ka mbështetur gjithsej 824 qytetarë nga Komuna e Prishtinës me sëmundje malinje dhe të ngjashëm, prej të cilëve 540 ishin të gjinisë femërore, kurse 284 i përkisnin gjinisë mashkullore;
- Identifikimi i adresave të pacientëve me hemodializë dhe shërbime shtëpiake rreth mirëmbajtjes dimërore të rrugëve;
- Identifikimi i nevojave rreth renovimit të objekteve KPSH-së 2021;
- Takimi i tretë i komitetit drejtues të Projektit - (KDP): “Avancimi i kapaciteteve për të drejtat e fëmijëve”;
- Me mbikëqyrjen e ekipeve të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike, përfunduan punimet e sinjalizimit për rregullimin e kyçjes direkte për hyrje-daljet në Qendrën e Mjekësisë Urgjente (QMU) në rrugën “Fehmi Lladrovci”.

Me këtë do të ndihmohet që koha e intervenimit në raste urgjente të vazhdon të ulet nën mesataren e 6 minutave.



- Personelit shëndetësor iu shpërndanë kartolina nga fëmijët e komunës së Prishtinës, në shenjë mirënjohje për gjithë punën e palodhshme që bëjnë çdo ditë e në çdo situatë.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR**

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Identifikimi i nevojave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore edhe gjatë gjendjes emergjente si pasojë e pandemisë globale;
- Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit shëndetësor edhe gjatë gjendjes emergjente si rezultat e pandemisë globale;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore.

#### **5. STATISTIKAT**

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

**5.1.1.** Buxheti i planifikuar dhe ai shpenzuar për periudhën raportuese.

**5.1.2.** Takimet me palë.

**5.1.3.** Takime me institucione të tjera:

- Drejtoria e Investimeve Kapitale;
- Drejtoria e Prokurimit;
- Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Zyra e Regjenerimit Urban;
- DSHPMSH.

#### 5.1.4. Diskutime publike - takimet me qytetarë.

Raportime të përditshme me media lokale: RTV 21, RTV Dukagjini, TV Klan dhe RTK;

#### 5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare;

#### 5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër;

#### 5.1.7. Përfitues të subvencioneve;

#### 5.1.8. Takime të tjera.

- MSH,
- IKSHP,
- QKMF,
- QMU;
- Ministria e Administratës Publike.

## 6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;
- Mungesa e shefit të DSH tani e sa vite;
- Mungesa e stafit shëndetësor në objektet KPSH;
- Trajnime të ndryshme të personelit - DSH - përgjegjësitë e përditshme zyrtare;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë "Mallra dhe shërbime", ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

## 7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;

- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme profesionale.

## 8. TË TJERA

Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

## QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

### RRJEDHA E PUNËS

- Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:
  - o Tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) kanë vazhduar punë pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 - 13:30; 13:30 - 19:00 dhe 19:00 - 07:00).
  - o Katër qendrave të tjera (QMF 2, QMF 6, QMF Besi dhe QMF Hajvali) gjatë dhjetorit kanë punuar me orar të punës prej: 07:00 - 19:00, dhe kujdestari fundjave: 07:00 - 19:00 të shtunave dhe 07:00 - 13:00 të dielave;
  - o Në qendrat tjera (QMF 1, 3, 8, 9, 10, 11, Mat dhe Mat 1, si dhe AMF Bardhosh) është punuar në një ndërrim nga ora 08:00 - 16:00, si dhe në AMF Mramor, AMF Shkabaj dhe AMF Keqekollë (07:00 - 14:00);
- Ky organizim i punës është bërë për të përballuar nevojat dhe kërkesat për zbatimin e masave, rekomandimeve dhe obligimeve tona kundruall parandalimit dhe frenimit të pandemisë COVID-19, përkundër mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit;
- Numri i stafit të infektuar deri më 31 dhjetor 2020, ka arritur shifrën prej 339 persona, prej të cilëve vetëm nga 19 tetori 2020 janë regjistruar 149 të infektuar, mes tyre edhe së paku tre veta që për herë të dytë janë konfirmuar pozitiv;
- Në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, në hyrje kanë vazhduar të qëndrojnë ekipet e përbëra nga (mjeku familjar dhe infermiera) për triazhimin e pacientëve;
- QMF 7 "Emshir" ka vazhduar të shërbejë si qendër për administrimin e terapisë parenterale për qytetarët e Prishtinës të infektuar me COVID 19 edhe gjatë muajit dhjetor, në dy ndërrime, 8 orëshe: 8:00 - 16:00 dhe 16:00 - 24:00;
- Gjatë muajit dhjetor janë administruar 7527 infuzione intravenoze (3982 ose 128.5 brenda 8 orësh, në ndërrimin e parë dhe 3545 gjatë ndërrimit të dytë, ose 114.4 infuzione në ndërrim) me një mesatare prej rreth 242.8 infuzionesh për 16 orë me varijime prej 306 (me 20 dhjetor) deri më 174 (30 dhjetor 2020), dhe me një trend të uljes graduale;
- Prandaj, puna në QMF 7 ka vazhduar me kapacitet të rritur (gjithsejtë 23 shtretër) dhe potencial të shtuar resursesh humane;
- Ndërkohë në QMF 7 ka filluar të ofrohet edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës, ndërsa në QKMF edhe analiza e D-Dimerit, që të dyja këto falas;

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërrimi i para ditës, pas ditës dhe ndërrimi i natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze.

**Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik ka vazhduar punën në të gjitha QMF-të me orar të rregullt dhe ka kthyer të gjitha shërbimet e veta në funksion.**

### **VËREJTJE**

Të dhënat statistikore mbi numrin e vizitave dhe shërbimeve do t'iu dërgohen në ndërkohë nga Znj. Hamzai.

### **REKOMANDIM**

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë dhe ruajtjes së dinjitetit të pacientëve dhe privatësisë së tyre, por edhe duke pasur parasysh përçindjen tashmë të lartë të personelit të infektuar, si dhe popullatës, e konsideroj të panevojshme vazhdimin e aplikimit të tavolinave të triazhimit në hyrje të institucioneve.

Prandaj, propozoj që të njëjtat, duke filluar nga java që vjen (11 janar 2021), të hiqen prej andej dhe të vazhdojë puna në mënyrë normale nëpër ordinanca, me masa mbrojtëse të aplikuara në mënyrë të rreptë.

- Përndryshe, gjatë muajit dhjetor 2020 janë realizuar gjithsej 212755 shërbime shëndetësore:
  - ✓ 61915 vizita mjekësore;
  - ✓ 83392 shërbime shëndetësore;
  - ✓ 55100 shërbime laboratorike;
  - ✓ 9473 shërbime stomatologjike;
  - ✓ 2875 shërbime radiologjike.

### **QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE**

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë muajit dhjetor vazhdoi organizimin e brendshëm, duke u përshtatur me situatën epidemiologjike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore urgjente për të gjithë banorët e komunës së Prishtinës.

Rastet urgjente u trajtuan sipas prioriteteve të urgjencës:

- Hipertension arterial;
- Astma bronchiale;
- Sëmundjet kronike obstructive të mushkërive;
- Gjendjet febrile me etiologji virale, si gripi sezonal;
- Rheumatoid artriti të adultet;
- Gjendjet febrile të dyshimta për COVID-19;
- Lumboichialgia ac;
- Gjendjet me abdomen akut;
- Colicat renale acute;
- Syndromi akut koronar;
- Syndromi anxyozo depresiv;

- Aksidentet e trafikut etj.

QMU-ja, kishte mesatarisht rreth 200 thirrje gjatë 24 orëve në linjën emergjente tel.194 nga ana e qytetarëve.

Gjatë periudhës raportuese në QMU 4, ..... punonjës rezultuan pozitiv në COVID-19.

Në kuadër të EVM-së, përmes takimit virtual, u mbajt ligjërata:

- Vertigo dhe sindroma veriginoze!

Numri i shërbimeve shëndetësore gjatë muajit dhjetor 2020:

1	Vizita mjekësore urgjente në terren	1303
	Vizita mjekësore të tjera	97
2	Vizita mjekësore të QMU	4
3	Shërbimi i kirurgjisë së vogël	0
4	Shërbimi i rea. në terren	3
	Shërbimi i rea. në QMU	0
5	Observim (Intenziv)	0
6	Shërbimi i infermierisë	0
7	Aksidentet	85
8	Fatkeqësitë në punë	9
	Fatkeqësitë të tjera	54
9	Shërbimi laboratorik	19
10	EKG	13
11	Transportet	250
12	Konstatim vdekjeje	80

Gjithsej 1917